



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.1.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Albana Vokshi – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 23, 24 dhe 26 nëntor; 3, 4, 5, 11 dhe 17 dhjetor 2018.
2. Diskutimi i kalendarit të punës së Komisionit.

Marrin pjesë:

Albana Vokshi, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Mirela Kumbaro, Lindita Nikolla, Almira Xhembulla, Adelina Rista, Fadil Nasufi, Ismet Beqiraj, Bujar Çela, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Kejdi Mehmetaj, Endri Hasa (deputet zëvendësues i PD-së), Floida Kërpaçi (deputete zëvendësuese e LSI).

Mungojnë:

Romeo Gurakuqi dhe Nora Malaj.

HAPET MBLEDHJA

Albana Vokshi – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e radhës së Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Fillimisht, dua t'u uroj mirëseardhjen dy ish-ministreve znj.Kumbaro dhe znj.Nikolla, të cilat do të jenë që sot pjesë e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Pika e parë e rendit të ditës së kësaj mbledhjeje është miratimi i procesverbaleve të datave 23, 24 dhe 26 nëntor; 3, 4, 5, 11 dhe 17 dhjetor 2018.

Sekretarja ia ka dërguar të gjithë anëtarëve. Besoj se anëtarët e maxhorancës i kanë parë, sepse opozita nuk ka qenë pjesë e këtyre mbledhjeve. A jeni dakord me procesverbalet? A keni komente, shqetësime? Nëse po dhe nuk janë reflektuar akoma, ju lutem të kontaktoni me sekretaren!

Miratojen procesverbalet.

Pika e dytë e rendit të ditës është diskutimi dhe miratimi i kalendarit të punës së komisionit.

Në kalendar kemi diskutimin e amendamenteve të propozuara nga Grupi Parlamentar i LSI-së, konkretisht, nga deputetet Kejdi Mehmetaj dhe Floida Kërpaçi, në lidhje me ligjin “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Ne kemi kërkuar që edhe amendamentin tjetër i LSI-së për rritjen e buxhetit për arsimin, meqë e kanë dërguar për shqyrtim vetëm në Komisionin e Ekonomisë, ta sjellin edhe në komisionin tonë për diskutim, pasi mendoj se të gjithë biem dakord që kjo është një çështje, e cila duhet trajtuar edhe në këtë komision. Unë shpresoj shumë që Komisioni për Ekonominë ta marrë parasysh kërkesë tonë, pra të mund të kemi edhe një projektligj tjetër në agjendën e këtij komisioni. Kemi dërguar, unë kam komunikuar edhe me kryesinë e komisionit në lidhje me kalendarin të paktën për 2 javët e ardhshme, për të filluar menjëherë me diskutimin e amendamenteve të LSI-së për ligjin “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Nuk kam pasur asnjë koment nga zonja Ekonomi apo nga zoti Ylli. Nuk e di nëse jeni dakord në parim në lidhje me kalendarin e propozuar, apo keni komente dhe sugjerime të tjera në lidhje me të. Besoj se të gjithë e keni marrë dhe e keni përpara projektkalendarin e punës së komisionit.

Milva Ekonomi – Faleminderit shumë, zonja Vokshi për ardhjen tuaj sot dhe për fillimin e një pune të mbarë të komisionit në këtë vit të ri kalendarik!

Faleminderit edhe për draftin e kalendarit!

Ne e kemi parë kalendarin dhe mendojmë se nisma për ndryshime është një kërkesë legjitime e bërë nga deputetet Kejdi Mehmetaj dhe Floida Kërpaçi, të cilat do t'i diskutojmë në komision. Në kalendarin e aktiviteteve të Kuvendit ky projektligj është vendosur në datën 31 janar dhe ne mendojmë se nisur nga shpejtësia e draftimit dhe nga kërkesa për hartimin e tij, që dëgjesat që kemi për këtë projektligj të përfundojnë deri nesër në darkë në mënyrë që ne të bëjmë gati procesverbalin për ta futur në diskutim në seancën plenare të datës 31 janar. Ky është propozimi ynë për kalendarin. Ne e shqyrtuam edhe në mbledhjen e grupit dhe thamë se është e rëndësishme që këto gjëra të kalojnë.

Albana Vokshi – Faleminderit, zonja Ekonomi!

Unë e diskutova edhe me Shërbimin e Seancës për shtyrjen e kësaj çështjeje. Ky është një vendim që e merr komisioni. Kemi 2 propozuese, me një të propozuese të amendamentit është diskutuar dhe është dakordësuar me to për t'u lënë më shumë hapësirë për të mos bërë dëgjesa sa për të kaluar radhën, sepse jemi të qartë që kjo ju shërben juve. Do të marrim kohën e duhur qoftë për të dëgjuar propozueset e amendamenteve, qoftë grupet e interesit. Ne kemi kërkuar që ministrja e Arsimit të vijë këtu. Ne do të marrim kohën e duhur, sepse problematikat që do të shqyrtojmë kemi për t'i diskutuar me ministren e re, por për fat, kemi edhe ish-ministren në komision.

Pra, kemi një sërë problematikash në lidhje me ligjin “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të cilat nuk duhet t'i anashkalojmë apo t'i trajtojmë në mënyrë të përciptë. Kjo është çështja më themelore dhe më kryesore, që po diskutohet tashmë jo vetëm prej studentëve, por edhe prej familjeve të studentëve, edhe prej deputetëve. Pra, sytë e të gjitha shtresave të shoqërisë janë fokusuar te

studentët dhe te trajtimi dhe zgjidhja e çështjeve, që kanë lidhje me kërkesat e tyre sa më parë. Besoj se kjo është detyra jonë primare, që kapërcen çdo axhendë tjetër politike.

Urdhëroni!

Luçiano Boçi – Faleminderit!

Unë do të thosha që nuk jemi në kushtet e procedurës së përshpejtuar. E kuptoj kërkesën e maxhorancës për ta futur për shqyrtim në datën 31 janar, siç është parashikuar, por pretendoj njëkohësisht që jemi para një kërkesë për ndërhyrje në një ligj shumë të debatueshëm dhe dëgjimi i grupeve të interesit është i domosdoshëm, ashtu si edhe dëgjimi i ministres përkatëse për opinionin e saj mbi kërkesat që ka bërë Grupi Parlamentar i LSI-së.

Përderisa sot debati është fokusuar te abrogimi i këtij ligji, unë besoj që propozimi i Grupit Parlamentar i LSI-së do të shërbejë për të hapur një debat të gjerë parlamentar pikërisht për kërkesën që ka sot pedagogu, studenti dhe opinionin publik për abrogimin e ligjit “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Është momenti që bashkë me amendimet e kërkuara të diskutojmë gjerë e gjatë me grupet e interesit, të cilat janë shmangur. Edhe në rastet kur janë dëgjuar, është bërë sikur janë dëgjuar, sepse kur u rikthehem debateve të atëhershme për këtë ligj, të gjithë përfaqësuesit e universiteteve, të seneve, të rektorateve, të përfaqësive të studentëve janë shprehur kundër këtij ligji. Po deshët për vërtetim hajdeni të hapim procesverbalet, sepse unë nuk marr në konsideratë reagimet e atyre që nuk kanë qenë prezent, por marr në konsideratë reagimet e atyre që kanë qenë prezentë në diskutime. Për ta vërtetuar këtë, le t’u drejtohem procesverbaleve, sepse universitetet kanë sjellë çarçafë të tërë me argumente ligjore dhe nuk është marrë asgjë në konsideratë nga ju. Prandaj le të përfitojmë, se siç e thashë, se nuk jemi në kushtet e emergjencës ligjore dhe të diskutojmë thellësisht dhe seriozisht për abrogimin e këtij ligji.

Faleminderit!

Kejdi Mehmetaj – Faleminderit, kryetare!

Unë do të flas në përgjithësi për procedurën e ndjekur për propozimet që kemi bërë. Në momentin që ne kemi bërë propozimin, ka qenë dita e tetë e protestës së studentëve, një nga protestat më masive të studentëve, të cilët ishin përballë Ministrisë së Arsimit në atë kohë. Përveç propozimeve që kemi bërë, kemi kërkuar që këto propozime të shqyrtohen me procedurë

të përshpejtuar, duke marrë parasysh situatën emergjente dhe nevojën për zgjidhje dhe për shqyrtim në komisione, ashtu siç tha edhe kolegia Milva.

Megjithatë, maxhoranca në parlament vendosi në atë kohë që nuk ka asnjë domosdoshmëri që këto propozime që kemi bërë, t'i kalojmë në mënyrë të përshpejtuar, për të zgjidhur një ngërç të madh, qoftë edhe nëse pala tjetër nuk do të ishte dakord me këtë zgjidhje, por do të kishte një zgjidhje më të mirë.

Përderisa në atë moment, kur ishte vërtet piku i protestës së studentëve, maxhoranca nuk e pa të arsyeshme ta kalonte në mënyrë të përshpejtuar këtë projektligj, çfarë e nxiti sot që mos na lërë kohën e duhur për t'u konsultuar me të gjitha grupet e interesit dhe për të marrë vendimin e duhur?

E them me bindje, ashtu siç tha edhe kolegu, se është e rëndësishme që nëpërmjet këtij amendimi që kemi bërë, që në mënyrë të drejtpërdrejtë është kërkesa e studentëve e thënë me firmën tone, në pamundësi të tyre për të mbledhur në një kohë të shkurtër 20 mijë firma, do të shërbejë padyshim për të hapur një debat konstruktiv për ta përmirësuar apo për ta abroguar, për të bërë një ligj të ri. Pra, kjo do të jetë ajo, që ne do të shohim gjatë rrugës. Këtë nuk e vendosim dot sa jemi ne këtu, por kemi nevojë të konsultohemi me studentët, me pedagogët dhe me grupet e tjera të interesit, gjë që nuk e bëjmë dot brenda ditës së nesërme. Unë mendoj se vetëm dëgjesa që do të kemi me njëri-tjetrin dhe me ministren, do të na marrë një ditë të plotë pune, jo më pastaj të mendojmë studentët, që janë të shumtë, studentët protestues, pedagogët, pavarësisht se përfaqësojnë mendime të ndryshme për mënyrën se si duhet të vazhdojë arsimi i lartë. Për këtë arsye mendoj të marrim kohën e duhur. Jam e bindur se nëse bëjmë një punë intensive, të enjten tjetër ne do të kemi mundësi t'i kalojmë amendimet në parlament.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Nuk është eksperiencia e parë. Ne kemi vepruar në këtë mënyrë, kur nuk kemi pasur kohë të mjaftueshme për të diskutuar një projektligj të caktuar, kemi marrë edhe 1-2-3 javë. Arsyeja pse është futur në kalendar, edhe sipas specialistëve me të cilët unë bisedova para mbledhjes, ishte thjesht respektimi i afatit 8-javor për t'u futur në kalendarin e një komisioni. Përtej kësaj, është komisioni ai që vendos për shtyrjen e diskutimit në seancën plenare të këtij amendamenti. Propozuesja është më shumë se dakord për të marrë kohën e duhur. Ftoj edhe kolegët e maxhorancës të dakordësohen me këtë.

Edhe ju keni shansin që të dakordësoheni tashmë, pavarësisht se nuk e diskutuat në kohën dhe në mënyrën e duhur në muajin dhjetor, që ne ta fillojmë që nesër diskutimin në mënyrë të detajuar dhe të thelluar të çdo problematike që ka krijuar ligji për arsimin e lartë apo kërkesat e studentëve dhe, pse jo, edhe pakti për universitetet.

Urdhëro, Luan!

Luan Baçi – Unë sinqerisht do t'i ftoj kolegët e maxhorancës që këtë radhë, duke parë situatën, se vërtet nuk është thjesht një kërkesë e deputetëve të opozitës, ashtu siç është diskutuar kur u miratua ky ligj. Në fakt, me arrogancën që ju karakterizon, na keni skandalizuar atëherë, duke thënë se ligji do të ishte një sukses i padiskutueshëm, një risi. Koha vërtetoi brenda një kohe të shkurtër që ligji është shumë problematik.

Unë jam dakord me pjesën e dytë të fjalës së Mehmetajt, kur u shpreh se është për abrogimin e këtij ligji, jo për amendimin e këtij ligji. Deputetët e PD-së kanë qenë kundër këtij ligji dhe mua më vjen mirë që sot edhe studentët, edhe pedagogët kanë ardhur të gjithë me një propozim të njëjtë me atë të PD-së, që ky ligj duhet abroguar dhe duhet hartuar një ligj i plotë, i saktë, i diskutuar dhe i mirëtrajtuar me të gjitha grupet e interesit. Që të ndodhë një gjë e tillë, është e domosdoshme të bëhen dëgjesa, ashtu siç tha kryetarja e komisionit, zonja Vokshi. Duhet t'u japim kohën e duhur. Unë mendoj që në këtë diskutim nuk ia vlen të nxitojmë dhe të fusim për diskutim këto dy amendime në seancën plenare të ditës së enjte. Zonja Mehmetaj e argumentoi shumë mirë që ato kërkesa kanë qenë në pikun e protestës së studentëve. Sot atyre u ka kaluar koha dhe unë mendoj se ato amendamente nuk janë më për t'u diskutuar. Këtu është për t'u diskutuar ligji "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", gjë që do kohën e duhur për të bërë diskutimet dhe dëgjesat e duhura me të gjitha grupet e interesit. Unë mendoj se duhet t'u bashkëngjitemi këtyre propozimeve që u dhanë këtu, sepse kjo është në të mirën e përbashkët të studentëve, të pedagogëve dhe të gjithë arsimit në përgjithësi.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Ne themi se kjo është në të mirën e studentëve dhe në të mirën e përbashkët dhe unë jam dakord me këtë. Për këtë unë mendoj që ta fusim diskutimin e kësaj nisme në Kuvend në datën 31 janar, sepse të gjithë jemi të të njëjtit mendim. Ndryshimet që po bëhen në këtë ligj, projektpropozimi që ka ardhur ka të bëjë vetëm me përfaqësimin e studentëve

në vendimmarrje, kështu që kjo është një gjë shumë e vogël në krahasim me kërkesën që parashikoni ju sot, që ne duhet të marrim hapësirën për të diskutuar ligjin “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Në fakt, ardhja e kësaj shkrese në komisionin tonë ka ndodhur më 13-14 dhjetor dhe është depozituar në Kuvend më 12 dhjetor. Mund të ketë ardhur në darkën e datës 13 dhjetor, se varet se kur e kemi hapur *e-mail*-in. Ndërkohë, nëse e kujtojmë, afati i fundit i grumbullimit të Kuvendit (për mbledhjet e zakonshme) ka qenë më 21 dhjetor.

Ndërkohë, ka nevojë të vendosim disa gjëra të rëndësishme: në momentin kur bëhej protesta studentore, u dëgjuan me vëmendje kërkesat e studentëve, menjëherë qeveria reagoi me VKM-të dhe me paktin për universitetin. Disa gjëra edhe nga këto që kërkohen sot, kanë gjetur shpjegim dhe përgjigje, dhe duhet të marrim në konsideratë që ka një...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më falni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë nuk ju ndërpreva fare. Kështu, më lini të flas! Unë nuk i ndërhyra asnjërit. Edhe kur ju nuk e respektuat radhën e diskutimeve, unë nuk ju ndërhyra. Ju lutem, më lini të mbaroj!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë mendoj se është shumë e rëndësishme që të marrim në konsideratë faktin që qeveria ka një angazhim të lartë, të rritur për realizimin e kërkesave të studentëve. Pikërisht me këtë logjikë, që duhet të kemi një angazhim të lartë për plotësimin e kërkesave të studentëve, është edhe reagimi i të gjithë komisionit. Kështu, unë mendoj që duhet të ketë një reagim të shpejtë, të menjëhershëm karshi kërkesave të studentëve. Edhe zonjat prandaj e bënë kërkesën për ndryshimin e ligjit. E kanë bërë në datën 12 dhjetor për një gjë që është në diskutim e sipër.

Albana Vokshi – Erdhi në datën 12 dhjetor dhe sot jemi më 28 janar...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mos pretendoni që ju po shqetësoheni për studentët!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem!

Propozuesja...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E keni pasur para, Milva.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mos bëni sikur po qani për studentët! Ju e keni pasur edhe gurin edhe arrën në dorë dhe nuk keni vepruar, nuk keni dashur ta bëni. Jeni tallur me studentët dhe po vazhdoni të talleni edhe me propozimin tuaj për ta futur më 31 janar. Ky është vazhdimi i talljes dhe i fyerjes, që ju po u bëni studentëve.

Përderisa propozuesja e amendamentit kërkon t'i japim më shumë kohë, sepse është e rëndësishme që të mos të vazhdojmë të tallemi, ashtu siç keni bërë ju deri tani, duhet që ta shtyjmë edhe për një javë tjetër çdo diskutim dhe çdo dëgjuesë. Kemi një radhë të madhe studentësh, pedagogësh dhe ministrash që duam t'i thërrasim për t'i dëgjuar, të paktën ne, të opozitës. Ndaj, është në nderin tuaj të bini dakord dhe të fillojmë punën. Të mos merremi me... Propozuesja kërkon shtyrje, që është brenda çdo procedure parlamentare. Ashtu sikurse kemi vepruar..., kemi precedentë pa fund edhe në komisionin tonë.

Tani, kur propozuesja thotë: “Po, e shtyjmë”, ju, që tani po na qani me lot krokodili, thoni: “Jo, jo, sepse duhet ta bëjmë në datën 31”! Ju lutem, lërin këto! Kemi hartuar një draftkalendar, hajdeni! Bazuar në këtë, nëse keni komente ose sugjerime për dëgjuesat të tjera, i shtojmë, ama, ju lutem, boll me tallje për studentët! Të vazhdojmë punën e komisionit normalisht.

Fjalën e ka zoti Rrokaj.

Shezai Rrokaj – Tani, LSI-ja ka bërë dy propozime, ku njëri ishte për buxhetin, i cili nuk u gjykua se ishte i nevojshëm, 1% i prodhimit të brendshëm bruto për të ezauruar një pjesë të problematikave të studentëve, ndërsa propozimi i dytë kishte të bënte me pjesëmarrjen e studentëve në organet kolegjiale. Por kanë rrjedhur shumë ujëra, që besoj se kanë ngritur disa problematika për arsimin, që vetë qeveria i ka pranuar, vetë qeveria është angazhuar në shkallë të gjerë për t'i realizuar, por që doemos këto problematika të çojnë te ligji. Bie fjala, shumë nga çështjet që kanë ngritur studentët kanë të bëjnë me raporte të caktuara ndërmjet organeve kolegjiale akademike apo titullarëve të tyre dhe organeve kolegjiale, si dhe me pjesëmarrjen në borde të qeverisë, që ka një pjesëmarrje më të lartë në disa universitete, me përjashtim të atij të Tiranës.

Milva Ekonomi – Varet nga të ardhurat.

Shezai Rrokaj – Tani, në qoftë se është me të varur, ne e kemi pa të varur. Domethënë, ne themi se janë ngritur disa problematika nga studentët, nga profesorët, që duhen parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtu nuk është problemi që me kokëfortësi të themi se e kemi miratuar ligjin dhe nuk mund ta shikojmë. Kanë kaluar gati tre vjet, që bëjnë të mundur edhe rishikimin e problematikave në terren, edhe sikur të kenë qenë perfekte. Nganjëherë, terreni të jep mundësinë të shikosh se disa gjëra nuk shkojnë, dhe vërtet nuk shkojnë.

Përderisa ka një konsensus kaq të gjerë publik: profesorë, studentë, për ta riparë ligjin, çfarë jemi ne këtu? Një grup përfaqësuesish politikë, që nuk shikojmë një gjë, që është shumë më e gjerë sesa çfarë përfaqësojmë, kuptohet, përfshirë edhe ne. Kështu që, unë mendoj t'i lëmë këto deklarata apo mendime, t'i bindemi sovranit, pasi sovrani ka kërkuar rishikimin e ligjit dhe ka ngritur disa çështje shumë të rëndësishme, që nga karta e studentit, si do të realizohet, çfarë do të nënkuptojë; që nga sa për qind të prodhimit të brendshëm bruto...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë e mirëkuptoj ministren! Ju kujtoni se ministrja nuk do të donte ta kishte 5% të prodhimit të brendshëm bruto për arsimin? Hajdeni ta ndihmojmë edhe ministren e re, por ne duhet ta dëgjojmë atë se çfarë mendjeje ka për arsimin. Si do ta kalojmë ne, qoftë edhe këtë amendim për pjesëmarrjen, pa dëgjuar edhe një herë studentët, pa parë modelet? Se duhet të shikojmë edhe modelet. Ndoshta ideja që thonë studentët duhet realizuar deri në njëfarë mase. Në fakt, kemi edhe një traditë tonën, deri në 20%. Pra, unë them që kërkesat e shtruar meritonin që ne të ulemi dhe t'i shikojmë në kohën e duhur, duke dëgjuar përfaqësuesit dhe duke dalë me propozime konkrete, që sjellin një bashkëpunim të frytshëm ndërmjet ministrisë dhe deputetëve, sepse duhet ta kuptojmë mirë çfarë kanë thënë studentët. Studentët dhe pedagogët në përgjithësi e kanë përjashtuar politikën nga kërkesat e tyre. Të mos bëhemi këtu si murgjit e krishterë, të cilët, ju e dini se për çfarë flisnin, ndërkohë që po digjej e gjithë Kartagjena. Le të ulemi, t'i marrim gjërat një për një, të dëgjojmë ministren dhe pedagogët.

Ne, si komision, e kemi për detyrë, sepse na takon që ta fillojmë ne nismën në bashkëpunim me qeverinë, që të bëhen gjërat e nevojshme për studentët dhe pedagogët e Shqipërisë, jo për egon e njëres parti apo tjetres.

Albana Vokshi – Pra, të marrim kohën e duhur.

Po, zoti Boçi.

Luçiano Boçi – Tani jemi në kushtet kur “i zoti e jep, tellalli s’e jep”, i thonë kësaj pune, sepse propozuesja po thotë se nevojitet koha e domosdoshme për të dëgjuar grupet e interesit, ndërsa tellallët thonë: “Jo”. Kjo duket që nuk shkon.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pjesa tjetër, Milva, nuk jemi këtu për të diskutuar paktin për universitetin, sepse është një pakt bakalli. Në qoftë se doni opinionin e studentëve në lidhje me VKM-të antiligjore, që bien ndesh me ligjin e arsimit të lartë, jo më me Kushtetutën ose po, hajdeni t’i thërrasim studentët, t’i dëgjojmë dhe të marrim kohën e domosdoshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

T’i dëgjojmë mirë edhe grupet e pedagogëve, sepse grupi më vulnerabël sot nuk janë vetëm studentët, janë edhe pedagogët, të cilët janë sulmuar krejt padrejtësisht nga Kryeministri, janë sulmuar nga opinionin që është ngritur nga ju, nëpërmjet mekanizmave tuaj, sikur fajtorët kryesorë për gjendjen në të cilën është universiteti, janë ata. Jo, mor, jo, jeni ju, është ligji juaj, madje mbani përgjegjësi!

Prandaj, hajdeni të diskutojmë. Ju të mbani përgjegjësitë tuaja, të abrogojmë ligjin dhe t’i japim arsimit të lartë pamjen dhe mundësitë që ai vërtet meriton në Shqipëri.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ja, një sekondë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E kuptoj që keni frikë nga përballja me studentët, me pedagogët, këtë e shoh edhe nga reagimi juaj: “Kë do të ftoni, forumet?!”. Ju mbushët të gjitha studiot me FRESH-istë, pse keni frikë të thërrasim studentët, të paktën ata që kanë qenë në ballë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nga të gjitha partitë, mor, le të jenë, të vijnë dhe të shprehen!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sido qofshin, me parti, pa parti, janë studentë dhe kanë të drejtën e tyre! Mos kini frikë ju nga kjo përballje!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Përballuni, sepse ju po i dëmtoni! Është ligji juaj ai që i ka nxjerrë në rrugë dhe i ka ende të ngujuar sot e kësaj dite!

Përfaqësues nga studentët do të thërrasim. Bëni listën tuaj: me parti, pa parti, sillini këtu! Ta bëjë gjithsecili, flas gjithsecili deputet, që ka për të ftuar studentë ose ka pedagogë për të dëgjuar, i ftojme dhe i dëgjojmë! Ne nuk kemi absolutisht asnjë kompleks për të ftuar këdo që do të jetë këtu për të dhënë mendimet, sugjerimet apo shqetësimet e tij në lidhje me ligjin e arsimit të lartë, si dhe për paktin tuaj të mashtrimit të studentëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Por ajo që mua më ka shqetësuar jo vetëm si deputete, jo vetëm si politikane, por edhe si nënë, madje i kam bërë thirrje edhe ish-ministres, edhe ministres aktuale, është dhuna e ushtruar brenda ambienteve universitare. Nuk ka ndodhur asnjëherë një dhunë e tillë e urdhëruar nga lart!

As ish-ministrja dhe as ministrja aktuale, sot që flasim, nuk kanë mbajtur një qëndrim në lidhje me dhunën e ushtruar. Është antikushtetuese, është antiligjore! As Millosheviçi nuk ka ndërhyrë me dhunë në vitin 1981!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju vjen për të qeshur, zonja ish-ministre?! Nuk është për të qeshur, pasi besoj se keni fëmijë edhe ju!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk është për të qeshur!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të ushtrosh dhunë ndaj fëmijëve është e paprecedent, madje është e dënueshme dhe e papranueshme! Ndaj ju, si ish-ministre dhe si nënë, duhet të kishit reaguar e para, jo të heshtnit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sot e kësaj dite nuk ka një deklaratë kundër dhunës. Ndaj unë do të kërkoj që të thirret në mënyrë urgjente ministri i Brendshëm në komision. Pra, ministri Sandër Lleshaj të vijë nesër para këtij komisioni, për të raportuar arsyet pse është ndërhyrë me dhunë brenda ambienteve universitare.

Ne, si deputetë të opozitës, të gjithë, kërkojmë që zoti Sandër Lleshaj të paraqitet nesër në komision dhe të informojë deputetët e këtij komisioni në lidhje me arsyet që e shtynë Policinë e Shtetit të futet brenda ambienteve të universiteteve, duke dhunuar djem dhe vajza, në mënyrë antiligjore dhe antikushtetuese!

Në qoftë se ju bini dakord, nuk ka nevojë për të bërë shkresë. Në qoftë se ju nuk bini dakord, atëherë ne, të gjithë deputetët, duke mbledhur një të tretën e firmave, do ta dërgojmë shkresën nesër në mëngjes, në mënyrë urgjente, që ministri i Brendshëm të paraqitet para këtij komisioni.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – ...ditën që do të diskutojmë kalendarin.

Luçiano Boçi – Bëri një propozim për kalendarin.

Albana Vokshi – Ditën e nesërme e kemi bosh.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E bëj sot.

Sot po kërkoj: a jeni dakord ju të vijë ministri të na informojë dhe ne të dëgjojmë pse ai ka guxuar, në shkelje të ligjit dhe të Kushtetutës, të ndërhyjë në mënyrë të dhunshme brenda ambienteve universitare? A jeni dakord, apo jo?

Nëse jeni dakord, ne do të dërgojmë shkresë normale zyrtare nga komisioni. Nëse jeni kundër, dhe unë shpresoj të mos jeni kundër, sepse edhe për ju duhet të jetë i dënueshëm veprimi që ka bërë ministri i Brendshëm ose deklaratat që ai ka lëshuar, pasi ka ndërhyrë në mënyrë të dhunshme te studentët...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jeni dakord, Milva?

Milva Ekonomi – Hajde të diskutojmë kalendarin. Kemi kalendarin.

Albana Vokshi – Është brenda kalendarit, pra, për nesër!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Kemi disa gjëra për të diskutuar. Kështu që, hajde diskutojmë kalendarin dhe pastaj...

Albana Vokshi – Milva, është shtesë e kalendarit për nesër!

(Deputetja Ekonomi ndërhyr pa mikrofon.)

Po bëjmë një propozim.

Milva Ekonomi – Për kalendarin kemi dhënë një propozim përpara jush dhe kemi thënë që nesër duhet të vijë ministrja në dëgjesë, studentët dhe profesorati. Ne kemi bërë një propozim përpara se ju të vinit me këtë propozim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Jo, nuk e ke bërë këtë propozim! Kur e bërë?

Milva Ekonomi – Po, po, qëkur u hap seanca ta thashë këtë gjë, ndërkohë ti tani bën një kundërpropozim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jemi përpara dy propozimeve.

Luçiano Boçi – Është propozim shtesë, jo kundërpropozim.

Milva Ekonomi – Nuk është propozim shtesë.

Albana Vokshi – Zonja Ekonomi, qetësohuni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Unë jam shumë e qetë.

Albana Vokshi – Qetësohuni, zonja Ekonomi, i marrim me radhë!

Milva Ekonomi – Jam shumë e qetë, zemër!

Albana Vokshi – Qetësohuni!

Milva Ekonomi – Jam jashtëzakonisht e qetë!

Albana Vokshi – Dhuna ndaj fëmijëve tanë, e para, të trajtohet nesër në komision. Jeni dakord?

Milva Ekonomi – Ne jemi dakord që çështja e dhunës të trajtohet nesër në komision në orën 19:00, ku do të fillojmë dëgjesat me radhë, për ta mbyllur mbledhjen me këtë dëgjesë.

Albana Vokshi – Kush e caktoi këtë?

Milva Ekonomi – Po pra, do ta fusim!

Albana Vokshi – Jo, moj jo!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Jo, moj, zemër, se nuk mund të vendoset kështu!

(Deputetja Ekonomi vijon pa mikrofon.)

Luan Baçi – Milva, do të të lutesha...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Jo, jo, nuk jua dhashë fjalën!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luan Baçi – Ju lutem!

Do t'ju shtoj edhe një argument tjetër, në funksion të propozimeve të para, për shtyrjen që duhet t'u bëjmë dëgjësive dhe shtyrjen që duhet t'i bëjmë futjes së amendamenteve të ligjit të arsimit të lartë në seancë plenare këtë të enjte. Kemi një asamble të pedagogëve, të cilët i kanë dërguar edhe një shkresë qeverisë dhe Kryeministrit, me sa di unë, dhe kanë rreshtuar një sërë kërkesash të tyre, që janë në unison edhe me kërkesat e studentëve. Po në respekt të atyre pedagogëve, që kanë vënë një afat deri në datën 1 shkurt dhe presin një përgjigje, ne, si anëtarë të komisionit, nuk duhet të presim që t'u japë një përgjigje qeveria këtyre pedagogëve për kërkesat e parashtruara? Në respekt të këtyre pedagogëve, ne nuk duhet t'i thërrasim këta pedagogë që t'i dëgjojmë edhe këtu?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kjo është një kërkesë vërtet e sinqertë. Vërtet e shikoni serioze që koha e vënë në dispozicion nga ju është e mjaftueshme për ta bërë seriozisht këtë punë? Unë nuk besoj se është kohë e mjaftueshme për ta bërë seriozisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Madje do t'ju lutesha sinqerisht, sepse këtu duhet mirëkuptim, pasi edhe ju vetë do të merrni vlerësime pozitive edhe nga opinioni publik, edhe nga studentët, edhe nga pedagogët për qëndrimin që duhet të mbani. Kjo është të paktën njëfarë ndjese për atë ligj, që është ndërtuar në mënyrë të atillë, për atë ligj, që është kontestuar fort dhe, më lejoni këtu ta theksoj, nga deputetët e Partisë Demokratike. Nuk ka asgjë të keqe për të kërkuar ndjesë, nuk ka asgjë të keqe edhe për t'i rishikuar disa gjëra.

Sot nuk e vërtetojmë ne, si deputetë të Partisë Demokratike, por sot e ka vërtetuar praktika mësimore: e kanë vërtetuar studentët, pedagogët, si dhe ecuria e ligjit.

Ju në koshiencën tuaj jeni absolutisht të bindur, unë e di atë punë, por problemi është se është pak vështirë për t'i pranuar gjërat. Duhet pranuar kur gjërat nuk janë ashtu siç duhet të jenë, ndaj mendoj se diskutimi këtu është i tepërt. Këmbëngulja, për mendimin tim, është vazhdim i arrogancës që ju ka karakterizuar në vazhdimësi në diskutimet e shumë

problematikave këtu. Mendoj se është momenti të mos zgjatemi fare në këtë drejtim, por të jepni votën tuaj...

(Mungesë regjistrimi.)

Albana Vokshi – Pra, kemi kërkesën e propozuesve për ta shtyrë edhe një javë shqyrtimin e amendamenteve...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për të marrë kohën e caktuar.

Meqenëse propozueset dhe përfaqësuesi i LSI-së kërkojnë shtyrje, nuk ka asnjë arsye pse ju, Milva, të bëni akrobaci të turpshme për të thirrur nesër dhe për të bërë rrëmuja të zakonshme, për t'i shpëtuar përgjegjësisë suaj.

Nuk do t'i shpëtojë askush përgjegjësisë!

Meqenëse është kërkuar një javë shtyrje, do të lëmë një javë më shumë hapësirë për t'i bërë dëgjuesat ashtu siç duhen. Kjo është. Unë nuk e di pse kur propozuesit thonë: “Dua një javë më shumë”, ju thoni: “Jo, nuk e dua”!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E kupton?

(Deputeti Boçi ndërhyrje pa mikrofon.)

Mos u bëni kaq qesharakë në mënyrë të turpshme!

Po, zonja Duka.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më falni!

Po, zonja Bello.

Vilma Bello – Përsëritje!

Së pari, do të uroja ardhjen tuaj, pasi që kjo situatë problematike, të cilën e adresuan studentët dhe të cilës, me përgjegjësi të plotë, i është përgjigjur qeveria dhe të gjithë për të zgjidhur pjesën më të madhe, duke iu referuar të gjitha problematikave dhe kërkesave që ata shfaqën, madje më vjen mirë që pikërisht situata e tyre ju ka sjellë në komision.

Ajo që mua më bën përshtypje është sepse kur nuk ju pranuan fillimisht as studentët, sepse ishin ata fillesa e protestave, nuk ishit ju, sa herë shkonit, ju mënjanonin...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, zonja Vokshi, mos më ndërprisni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, se ju e keni zakon këtë! Si kryetare komisioni, ju lutem, mos ua ndërprisni fjalën anëtarëve të komisionit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Thoni të vërtetën!

Vilma Bello – Të mbaroj unë, pastaj fol ti!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë them të vërtetat e mia dhe më dëgjon kushdo, ashtu siç thua ti të vërtetat e tua dhe të dëgjojnë ata që duan të të dëgjojnë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për sa i përket konceptit të dëgjesave abuzive që ne paskemi zhvilluar në komision, ne nuk kemi zhvilluar dëgjesa abuzive në komision as kur kemi qenë vetëm, pra kur nuk ju kishim juve përballë në pjesën më të madhe të kohës. Këtu dua të të referohem më së shumti ty, si kryetare e komisionit, që gjithmonë nxit situata provokuese që të mos bëhet debat, por të kthehet në një sherr dhe në një tymnajë.

Sa i takon pjesës së paktit të mashtrimit, nëse qeveria ka referuar dhe u është drejtuar studentëve, të gjithë faktorëve të interesit dhe institucioneve të arsimit të lartë, duke adresuar problematikat e studentëve dhe kërkesat e studentëve, jo vetëm që nuk është një pakt mashtrimi, por ka lidhje të drejtpërdrejtë me një akt...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Po flasim për procedurë, kur të flasim në parim, do të flasim edhe për atë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vilma Bello – Në këtë moment që po flasim, nuk kemi pjesën më të madhe as të studentëve dhe as të pedagogëve që kanë protestuar, sepse e shohin që problemet e ngritura janë referuar, por, nëse ju doni ta përdorni politikisht, është shumë e qartë dhe shumë e sigurt, është diçka tjetër, sepse juve nuk u bëhet vonë as për studentët dhe as për arsimin e lartë. Mua më vjen keq që po flas me këtë gjuhë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Më fal, sepse jeni edhe pjesë e arsimit, por janë turp i madh këto që po thua.

Vilma Bello– Absolutisht nuk është e turpshme!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk po themi të mos dëgjojmë. Milva e tha që në fillim, meqë situata është e ngarkuar, ata kanë kohën e mjaftueshme që t'i dëgjojmë deri ditën e nesërme, sepse ata janë gati për të dëgjuar...

Albana Vokshi – Jo, si qenka kjo...

Vilma Bello– Mos ma ndërprit fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Propozuesi i ka bërë ato kërkesa, atëherë kur situata ishte e ngarkuar dhe, më pas, zgjidhja e këtyre problematikave u referua.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mos u turpëroni ju, sepse keni ardhur këtu me axhendë politike dhe jo me axhendë për universitetin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë jam nënë, jam grua, jam pedagoge, jam deputete dhe e kam shumë të qartë situatën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana, nuk turpërohemi ne që mbajmë përgjegjësinë e zgjidhjes, por turpin e mbani ju që keni ardhur me axhendë....

Albana Vokshi – Propozuesja e ka fjalën. Nuk është axhendë politike.

Vilma Bello – Axhenda jonë politike është për zgjidhje.

Albana Vokshi – Axhenda juaj është mashtrimi.

Vilma Bello – Ju e ngrini sot këtë tymnajë, vetëm se studentët dhe pedagogët nuk u bënë pjesë juaja.

Albana Vokshi – Dua t'ua jap fjalën propozuesve. Ju këshilloj të jeni në anën e duhur, mos u bëni palë e turpit dhe mashtrimit. Sot keni rastin të jeni të ndershëm me ata që ju kanë votuar, sepse keni edhe studentë që ju kanë votuar. Ju e patë se si e përzunë Kryeministrin në Vlorë dhe gjyqin që i bënë studentët. Pavarësisht se...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E dimë edhe si të ka sharë pas takimit me studentët, që nuk munde t'ia organizosh me FRESH-ista, ashtu siç e kërkoi. I dimë shumë mirë ne, mos mendoni që nuk e kemi marrë vesh edhe mënyrën se si jeni munduar ta...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E dimë edhe sharjen që të ka bërë personalisht ty për atë takim, ndaj më mirë tërhiq një hap pas...

Vilma Bello - Albana, mos fol me shifrat që do ti.

Albana Vokshi - Ne e dimë që gati ke qarë, sepse të shau, nga gjyqi që i bënë studentët.

Vilma Bello – Askush nuk mund ta marrë fjalën përveç meje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi - Shko thuaji Kryeministrit të mos ju fyejë...

Vilma Bello – Albana, do të ma japësh fjalën, sepse përndryshe unë nuk ju lë të vazhdoni mbledhjen normalisht!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Me shumë qetësi e ka...

Vilma Bello - Jo, në referim të drejtpërdrejtë...

Albana Vokshi – Nuk kemi replikë këtu. Lexoni Rregulloren, mos hajdeni pa lexuar. Për procedurë fjalën e ka Kejdi....

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vilma Bello – Ti nuk je gruaja që më mbron mua.

Kejdi Mehmetaj – Edhe një herë, duke ju kërkuar falje për ndërhyrjen, sepse paralelisht po prezantohet njeri nga amendimet në Komisionin e Ekonomisë, dua t'ju kthej në vëmendje se ky debat nuk na çon askund. Ju, si maxhorancë, jeni shprehur me votën tuaj në parlament që shqyrtimi me procedurë të përshpejtuar i këtij ligji nuk është i nevojshëm. Ju e bëtë këtë gjë në një moment kur nevoja ishte dhjetë herë më e madhe se tani, për të gjetur një zgjidhje emergjente, prandaj nuk shoh asnjë arsye përveç mungesës së dëshirës për t'u përballuar me ata që të vërtetat jua thane, pa pasur nevojë për këtë sallë. Kështu që, ju lutem, si propozuese po bëj kërkesë edhe një herë për të marrë të gjithë kohën e duhur, për të bërë të gjitha dëgjesa me grupet e interesit, në mënyrë që votimi ynë dhe juaji përfundimtar lidhur me këto amendime, të bëhet në bazë të kërkesave të vetë grupeve të interesit, që janë studentët, pedagogët dhe të gjithë ata që

janë të lidhur drejtpërdrejt me arsimin e lartë. Kjo nuk bëhet duke folur ju me njëri-tjetrin, sepse ju, si maxhorancë, keni folur me studentët atë çfarë keni pasur për të folur, e keni edhe përgjigjen nga ata; ne, po ashtu, jemi të qartë në qëndrimin tonë dhe duhet që në këtë sallë të dëgjojmë fjalën e drejtpërdrejtë të studentëve. Këtë duhet ta bëjmë, në radhë të parë, si prindër, për mua si bashkëmoshatare e tyre, për ata që janë gjyshër e me radhë, që të ndiejmë sot për fëmijët tanë dhe familjarët tanë, sepse ka ende studentë sot që flenë në fakultete dhe minimumi që mund të bëjmë është t'i dëgjojmë. Atje janë mbledhur asamblatë e pedagogëve, kanë folur senatet akademike, të cilët dinë më shumë se ne të gjithë për arsimin e lartë, prandaj duhet t'i dëgjojmë këtu dhe për këtë, nuk na pengon askush t'u japim atyre të drejtën të shprehen në këtë komision.

Edhe një herë po e përsëris, si propozuese kërkoj që të merret koha e nevojshme për të dëgjuar Ministrinë e Arsimit dhe të gjitha grupet e interesit, përfshirë grupet e mëdha të studentëve dhe pedagogëve. Një pjesë juaja, të cilët kanë qenë pedagogë, e dinë shumë mirë sa universitete ka në Shqipëri, sa fakultete ka në Shqipëri, sa senate akademike ka dhe sa grupe të ndryshme me vija të ndryshme mendimesh lidhur me universitetin ka. As ne dhe as ju nuk mund të bëjmë përzgjedhje që të dëgjojmë vetëm 2 dhe 30 të tjerë jo, sepse nuk ju pret koha për t'u përballuar dhe për t'i pritur ata dy, tre apo pesë ditë që të vijnë këtu dhe të flasim.

Edhe një herë po e përsëris, kërkoj të merret koha e nevojshme dhe të shtyhet miratimi ose mosmiratimi i këtij ligji në parlament deri të enjten e ardhshme.

Faleminderit!

Bujar Çela – Meqë na dhatë mundësinë të dalim nga tema, si zakonisht, të gjithë kishim menduar se dhëndri nuk do të përgatiste të njëjtën gafë, që pas 20 vjetësh për gafën që i ndodhi te vjehrrin tha që nuk do ta kujtojmë, por ju nuk mund të lëvizni nga istikami, jeni ata që keni qenë.

Unë mendoj se propozueset, duke i respektuar jo si kolege, por si studente, të mbarojnë shkollën dhe për ndryshimet që kërkojnë t'u japim afat pafund ta ndryshojnë ligjin në mandatin tjetër. Ligji është ende në tavolinë, është një ushqim i pakonsumuar dhe nuk i kemi parë pasojat e tij që të jetë helmuar dikush. Për ndërhyrjet që bëri qeveria me vendimet në përkrahje të protestës së studentëve dhe shqetësimit të pedagogëve, mendoj se jemi në kohën e duhur t'i trajtojmë në mandatin e ardhshëm.

Së dyti, unë propozoj ta nisim diskutimin aty ku e lamë, të bëjmë grafikun e punës në komision dhe këtë pikë që ju shtruat që në fillim, ta lëmë për në fund.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Qindra e mijëra studentë janë çuar në protestë dhe ju nuk i keni parë efektet e implementimit të ligjit?! Vetëm ti, Bujar, nuk i paske parë, më fal! Ndoshta nuk e keni parë nga fakti se Lushnja nuk ka universitet, por Tiranën të mbushur dhe të stërmbushur duhet ta kishit parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do ta bëjmë ne ligjin dhe ju do ta shihni.

Zonja Valentina Duka, fjala për ju.

Valentina Duka – Unë mendoj se Komisioni i Medias në parlament është komisioni më i rëndësishëm, kjo edhe për shkak të problematikës që ka lindur nga protesta e studentëve. Studentët kanë rreth një muaj që nuk bëjnë mësim. Ata janë të ndarë më dysh, kjo është fare normale, ku një pjesë mendojnë të bëjnë mësim, por një pjesë e madhe nuk duan të bëjnë mësim. Në fakultetin, të cilin kam pasur fatin ta drejtoj, nuk bëhet mësim, studentët kanë bllokuar auditorët dhe pedagogët i janë bashkuar grevës së studentëve. Ditën e premte ata janë mbledhur në një asamble, ku kanë adresuar disa problematika shumë të rëndësishme që lidhen me ligjin e arsimit të lartë. Në fakt, asambleja e Fakultetit Histori-Filologji ka qenë në pararojë të mosaprovimit të ligjit të arsimit të lartë nga qeveria, janë ngritur kundër “Paktit për universitetin”, sepse mendojnë se të gjitha VKM-të që kanë ardhur, prekin interesat e studentëve dhe të stafeve akademike.

Partia Demokratike nuk është për ndërhyrje të pjesshme në ligjin e arsimit të lartë, ajo është për abrogimin e këtij ligji, por në respekt të propozimeve që kanë ardhur nga LSI-ja, ne jemi këtu për të dëgjuar koleget e LSI-së dhe grupet e interesit. Ne duhet të dëgjojmë të gjithë studentët, të gjitha grupet e pedagogëve, si dhe ministren e Arsimit se cila është filozofia e paktit të universitetit. Edhe senati i Universitetit të Tiranës i ka quajtur antikushtetuese të gjitha VKM-të, prandaj është mirë që edhe ata t’i dëgjojmë. Ne nuk kemi pse të nxitohemi dhe t’i dëgjojmë brenda një dite të gjitha grupet e interesit, ne kemi shumë kohë për t’i dëgjuar dhe amendimet e LSI-së mund të kalojnë javën tjetër në parlament. Kështu që unë mbështes propozimin e Partisë

Demokratike, që amendimet të shtyhen dhe të kemi kohën e nevojshme për të dëgjuar të gjitha grupet e interesit.

Faleminderit!

Endri Hasa- Faleminderit, zonja kryetare!

A e kuptoni që po bëheni qesharakë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zotëri, ajo me vezën ishte shumë pak. Studentët vlojnë, zien Tirana, zien e gjithë Shqipëria dhe ju këtu bëni gallatë. Ju thoni: “Hajde ta mbyllim sa më shpejt, t’i vëmë kapakun, të votojmë kundër dhe të mos dëgjojmë opinionin”. Pse keni frikë t’i dëgjoni studentët?! Pse çirret ai Kryeministri juaj: “Dialog, dialog!”? Hajdeni, pra, dialogoni, pse nuk doni t’i dëgjoni ata, por doni t’i dëgjoni vetëm tri orë? Lërinë të vijnë këtu, jepuni kohën të vijnë të gjitha grupet e interesit! Nuk vihet këtu vetëm dy orë dhe ta mbyllim me vrap.

(Ilaritet në sallë.)

Mos qesh, Vilma, sepse u bëtë qesharakë. Doni t’i mbyllni me vrap, ashtu siç doni t’i vini kapak çdo gjëje. Cili ishte pakti?! Apo ndërruat ministren dhe thoni se fajin e kishte Lindita dhe jo Besa?! Këto nuk kanë lidhje, por hajdeni të dëgjojmë se cilat janë problematikat. Ky ligj duhet zhbërë, duhet abroguar. Grupet e interesit nuk e kuptuan atëherë, por studentët tani e kuptuan. Ne kemi 4 vjet radhazi që kemi ngritur zërin për këtë ligj. Pedagogët kanë dalë me vendimmarrje; studentët rrinë të ngujuar, por çfarë thoni ju? Hajdeni ta mbyllim me vrap.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të vijnë ata dhe të diskutojnë këtu.

Urgjentisht të vijë Sandër Lleshaj dhe të thotë se kush ka përgjegjësi që policia hyri në auditore. Kjo gjë nuk ka ndodhur në asnjë vend të botës. Në vitin 1981 Millosheviçi, kurse sot Edi Rama.

Të vijë dhe të tregojë këtu se cila ishte masha që futi policinë në auditore? Kush po i dhunon sot familjet e studentëve në të gjithë Shqipërinë? Ka sinjalizime nga e gjithë Shqipëria që po u bëhet presion prindërve me çdo mekanizëm dhe me çdo mënyrë. Nuk jemi këtu për të zhbërë atë që kërkojnë studentët, studentët duhet të marrin përgjigje. Qeveria nuk jep përgjigje, sepse është e papërgjegjshme, por nuk do të thotë se jemi të papërgjegjshëm edhe ne këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Minimumi ju duhet të keni respektin t'i dëgjoni, jo, hajde, t'i vëmë kapakun dhe ta kalojmë ditën enjte. Pse pritët një muaj e gjysmë për t'u mbledhur sot dhe për të thënë se nuk ka afat?!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Çfarë procedurash zbatuat? Ta kishit mbledhur atëherë. Kush nuk ju erdhi juve? Kur studentët ishin aty, pse nuk i thirrët Vilma?!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do të vazhdoj këtu, sepse njerëzit janë në situatë dramatike. Shkoni të gjithë dhe shikojini kushtet që kanë studentët në konvikte. Lindita e di mire, se i ka pare. Shikojini edhe ju të tjerët, shikoni situatën dramatike. Ata dalin dhe protestojnë, dalin dhe ngujohen dhe, nga ana tjetër, u hiqet energjia elektrike, u hiqen ngrohëset, dhunohen me çdolloj mekanizmi që të shuajnë kërkesat e tyre. Ata i kanë legjitime, buron nga Kushtetuta: e drejta për arsim është e para. Po e shkatërrojmë këtë vend, po e shkatërrojmë brezin e ri. Ata që protestojnë, nuk e kanë nga qejfi, ata nuk ngujohen nga qejfi, por sepse u ka shkuar aty ku nuk mban më dhe ne duhet të reagojmë. I pari duhet të reagojë ky komision. Nuk e kuptoj si mund të bëni thjesht fasadë dhe hajde ta mbyllim, hajde ta mbarojmë, se na iku halli! Ore, po shkatërrojmë një brez dhe për këtë jemi të gjithë përgjegjës këtu, të 140 deputetë, por i pari është ai, kryekomunari i Surrelit, por ai nuk merr përgjegjësi, prandaj hajde të marrim ne këtu, t'i dëgjojmë një herë. Ju keni frikë edhe të dëgjoni.

Jemi në emergjencë kombëtare, njerëzit po ikin, studentët janë në krizë. Ne po shuajmë një brez dhe pas 15 vjetësh do të themi: nuk ka më profesionistë, nuk ka më njerëz, nuk është më askush, të gjithë do të ikin nga ky vend.

Albana Vokshi – Faleminderit!

Në fakt, tani që ne jemi mbledhur këtu, më vijnë informacione që te Juridiku ka tensione, madje një studente është ndjerë keq dhe është shoqëruar me ambulance, dhe studentët pretendojnë se janë provokuar nga të tjerë që janë jashtë, pra janë thyer xhamat me gurë. Unë do t'ju ftoja juve, si deputetë të maxhorancës, t'i thoni Kryeministrit, t'i thoni ministrit të Brendshëm: “stop provokimeve”. Lërin studentët të protestojnë, se janë në të drejtën e tyre. Mos provokoni! Është turp që provokoni dhe i detyroni studentët, të cilët janë ngujuar me javë brenda

universiteteve, në sajë të shantazheve dhe presionit, të lëshojnë ambientet. Është e turpshme dhe e papranueshme, është shkelje e Kushtetutës, është shkelje e të drejtës për protestë!

Vilma Bello – Vlora nuk ka asnjë merak, e ka të zgjidhur merakun e saj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Albana Vokshi – Në mënyrë hileqare, dinake, ashtu siç dini ta bëni gjithmonë, erdhët pa sjellë minimalisht një propozim. Jua kam çuar që dje dhe nuk denjuat të sillnit një propozim tuajin. Erdhët këtu në mënyrë hileqare...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sigurisht, sepse e ka vendosur propozuesi, ju nuk vendosni dot për propozuesin.

Urdhëroni!

Vilma Bello – Zonja kryetare, sa për ato fjalët gjysma, që keni merakun e Vlorës, mos e kini merak Vlorën, sepse Vlora e ka zgjidhur atë dhe nuk pret që t'ia zgjidhë Albana Vokshi.

Për të drejtën e replikës, që të mos ju referohem, sepse është në nenin 50, dua t'i kthehem pak asaj që m'u drejtove pak më parë. Falë dhe faleminderit ligjeve të jetës që nuk klonohet një si ty, sepse të ishe ti në të gjitha situatat, edhe në universitetin e Vlorës, kushedi se çfarë do të kishit bërë me studentët. Ti do të ishe modeli më i gabuar i nënës, i gruas, i deputetes dhe i kryetares së komisionit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Jo, as denjoj t'i përgjigjem asaj që ju e quajtet replikë.

Në fakt, juve ju ka bërë Kryeministri njësoj, një model, miniatura të tij. Ai fyen, juve fyeni. Bravo ju qoftë për gjuhën që përdorni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne nuk merremi me këto.

Të lutem, zoti Boçi, mësoni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ky është model i Kryeministrit, ashtu siç bën ai, ashtu mundohen të përcjellin fjalorin, dhunën, shantazhin, fyerjet dhe kërcënimet. Mbajeni, shqyrt Zotit ka edhe deputetë si puna jonë, kjo ana e djathtë, dhe shqyrt Zotit flasin për çështjet dhe problematikat e fëmijëve tanë. Po, edhe si nënë, sepse ju si nëna nuk denjuat një herë të ngrini zërin, në mbrojtje të atyre fëmijëve që po protestojnë që në ditët e para të dhjetorit. Ju, si nëna, vetëm për atë karrigen tuaj, për karrigen e

ministres, që, për fat të keq, ta hoqi, i shërbeve 6 vjet, të hodhi... Pra, si nuk guxuat një herë të dilni në mbrojtje të tyre?! Bota është portokall, rrotullohet, kaq është! Vetëm këtë mendoni, asgjë më shumë.

Unë do ju ftoja të mos merremi më me këto. Çështjet dhe problemet që keni ju me Kryeministrin, zgjidhni vetë, nuk do të futemi ne, fare. Ne këtu do të trajtojmë çështjet e studentëve.

Ju lutem, vazhdojmë me çështjen e studentëve!

Edhe një herë propozimi i LSI-së.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Shezai Rrokaj – Propozimi i LSI-së që është bërë në dhjetor, i cili kapi një problem emergjent të studentëve, është të shtyhet dhe të hapet një debat i gjerë. Pse?! Sepse parlamenti, komisioni dhe deputetët nuk kanë bërë deri më sot një debat rreth kësaj problematike. Deri tani dimë se është përfshirë qeveria, por ne kemi rolin tonë, si deputetë. Ndaj propozoj: të hapet një debat i gjerë në komision me ministren e Arsimit dhe me ministrin e Brendshëm.

Zonja Vokshi, dua të them një detaj këtu: kush mund ta thërrasë policinë në universitet, administratori apo rektori, administratori apo dekani?! Ka një problem shumë të madh: administratori mund ta thërrasë policinë për sigurinë fizike, për procesin mësimor nuk ka lidhje administratori. Kështu që ligji ka lënë hapësira të tilla, që menjëherë në momente të caktuara cenohen ato, që në vitin 1968 studentët në Francë i fituan. Nuk lejohet të futet policia, edhe ligji e ka, por ligji ka lënë një titullar, ndërkohë që titullar nuk dihet se kush është. Ka titullar kështu dhe ka titullar ashtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Studentët e refuzuan politikën, studentët i refuzuan partitë politike. E dini pse?! Sepse në gjithë këto vite tranzicioni politika nuk është treguar e përgjegjshme me studentët dhe me profesorët. Ka bërë sikur është treguar e përgjegjshme, dikur për fushatat elektorale, dikur për interesa të caktuara, por problemet e universitetit dhe të shkollës duhen parë në ballë dhe në sy dhe sy për sy.

Prandaj, zonja kryetare, propozimi im është shumë i thjeshtë, ju që vendosni për kalendarin: të sillet një kalendar, që kësaj çështje, problemit të 8 kërkesave dhe ligjit t'i shkohet deri në fund nga ana jonë, si deputetë. Për këtë të bëhet një kalendar me ministrin, pedagogët dhe

studentët t'i dëgjojmë. Nuk na gjen asgjë në qoftë se i dëgjojmë dhe në qoftë se vendosim për ta ndryshuar. Çfarë është ky ligj që nuk u ndryshuaka?! Pse nuk ndryshohet? Ka shumë probleme. Nuk ka ardhur ajo e universiteteve të pavarura akoma, por mund të vijë nesër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po jua them, gjerat e mia i kam të shkruara. Në vitin 2014, kur u hap debati, jam shprehur hapur: unë nuk kam qenë dakord që LSI-ja ta votonte ligjin, po jua them shqip, hapur dhe qartë. Kam qenë kundër forcës sime politike. Ndonëse ata e kritikuan, por nuk mund ta merrnin me mend që djalli ishte fshehur te detajet. VKM-të dhe të gjitha këto e përkeqësuan edhe më shumë situatën. Prandaj, hajdeni ta përballojmë, të gjithë bashkë vendosim një kalendar, 1-mujor apo 2-mujor, t'i dëgjojmë edhe ata, të shikojmë se çfarë mendësie ka ministrja e re dhe t'u hyjmë punëve dhe t'i bëjmë për së mbari.

Arsimi është një e mirë publike, është një e mirë kombëtare. Çfarë lidhje ka LSI-ja, PD-ja apo PS-ja? Ne vetëm t'u qasemi dhe të shpëtojmë nderin në momentin e fundit, sepse deri më sot politika është e çnderuar përballë detyrimit që ka ndaj universitetit. Unë mbaj për aq sa më takon në politikë pjesën time të fajit, por kam qenë edhe dëshmitar i betejave të mia, edhe me PD-në, me PS-në dhe me rrogat e pedagogëve, kështu që nuk më vret e vërteta.

Zonja kryetare, bashkë me nënkryetaren dhe me përfaqësues të tjerë, të bëjmë një kalendar, t'i shikojmë në sy problemet për sa i përket pjesës sonë, si deputetë. Qeveria të bëjë punën e saj, ka kompetencat e saj. Ne kur të përballemi me vendimet e saj, mbajmë qëndrimet tona. Ky është propozimi im: të ulemi shtruar dhe t'i marrim problemet një për një, ashtu siç i kanë artikuluar profesorët dhe studentët.

Albana Vokshi – Në tavolinë kemi vetëm një propozim, nuk ka asnjë propozim nga PS-ja.

Luçiano Boçi – Zonja Vokshi, nisur nga situata e krijuar në Fakultetin Juridik, që ju e parashtruat, për provokimet që u bëhen studentëve, normal që gjatë kësaj kohe provokimet nuk janë bërë vetëm nga njerëz me uniformë, por edhe pa uniformë, që vijnë nga Policia Bashkiake dhe Policia e Shtetit. Unë e konsideroj emergjencën që ka maxhoranca. Po, ekziston një emergjencë, por emergjenca është për të thirrur ministrin e Brendshëm. Pra, që nesër, duke përputhur emergjencën që kanë kolegët e mi të nderuar dhe situatën që është sot në Fakultetin Juridik, situatën e ndërhyrjes së forcave policore në ambientet e universiteteve, urgjentisht

ministri i Brendshëm duhet të paraqitet para këtij komisioni, sepse profesori e tha shumë mirë: nuk është e përcaktuar qartë kush është titullari. Në fakt, unë e kundërshtoj këtu, sepse neni 5 e përcakton qartazi: “Ndërhyrja e forcave policore bëhet vetëm me lejen dhe kërkesën e titullarit”. Titullari më i lartë akademik, sipas ligjit të arsimit të lartë, është rektori dhe jo administratori. Në qoftë se në interpretim na konsiderohet edhe administratori titullar financiar i barabartë, që merret me sigurinë fizike, atëherë shkresa ka vlerë vetëm me firmë duale, me të dyja firmat dhe aspak me firmën e një shërbëtori politik, sepse zgjedhja e administratorit bëhet nga bordi i administrimit, që si shumicë ka përfaqësuesit e ministrisë. Pra, një njeri militant politik na kërkuaka ndërhyrjen e forcave të rendit, që s’ka ndodhur kurrë në historinë e Shqipërisë, te studentët! Këtu u përmend Milosheviçi etj. Sigurisht, historia duhet referuar, por të mos shkojmë shumë larg, të shkojmë në vitin ‘90. Edhe në vitin ’90 forcat policore nuk u futën brenda konvikteve, e dini apo jo? Edhe kur e nxorën Adil Çarçanin jashtë, nuk u futën forcat policore të regjimit të atëhershëm. Ju guxoni dhe i merrni zvarrë studentët brenda ambienteve të Fakultetit Juridik apo atij Ekonomik. Ne duhet të rrimë këtu. Është situatë emergjente. Duhet të vijë këtu ministri i Brendshëm që të përgjigjet për këtë ndërhyrje dhe të mbajë përgjegjësitë e tij ligjore e penale. Në qoftë se ai ka deklaruar se policia ka bërë mirë që ndërhyri, në çfarë shteti jemi? Në shtet ushtarak jemi ne këtu?! Paska bërë mirë policia që i tërhoqi zvarrë studentët! Kjo është e turpshme. Të vijë këtu e të mbajë përgjegjësitë e tij dhe të japë llogari para parlamentit, të mbajë edhe përgjegjësi ligjore, sepse do të ketë denoncim nga PD-ja.

Faleminderit!

Fadil Nasufi – Së pari, duhet të mësoheni me praktikën e menaxhimit të mbledhjes, me rend dite dhe me dokumente parlamentare. Këtu kemi një projektkalendar të punës, që besoj se e ka parë kryesia e komisionit, dhe një dokument të sigluar nga Kryetari i Kuvendit në lidhje me propozimin e LSI-për amendamente në ligjin për arsimin e lartë, i depozituar që më 12 dhjetor. Kështu që, në rast se LSI-ja dhe dy propozuesit kërkojnë shqyrtim, kjo është planifikuar më 31 janar konform procedurave parlamentare. Protesta e studentëve dhe propozimet e tjera që vijnë në tavolinë për abrogim të ligjit apo ndonjë koncept tjetër që kanë PD-ja apo aktorë të tjerë, politikë janë çështje të tjera. Kështu që, ose do të tërheqin propozimin nga seanca parlamentare për dy amendamente, ose nesër të fillojmë diskutimin sipas praktikës parlamentare.

Nëse doni kohë për axhendat e tjera, mbledhuni si kryesi, merrni propozime dhe shihni se cilët aktorë të tjerë do të thërrisni në lidhje me protestën dhe jo me propozimet. Bëni një kalendar të saktë dhe mos i hani kohë as publikut dhe as neve. Të fillojmë të diskutojmë protestën dhe të bëjmë komentet përkatëse, pra të futemi në rutinën që ka traditë komisioni ynë. Edhe sikur ne të flasim për axhendë tjetër, ju do të merreni me axhendën tuaj politike. Prandaj, propozoj të fillojë diskutimi i kalendarit të punës, sipas dokumenteve parlamentare që keni futur. Të hartojmë kalendarin, të mbajmë qëndrimin që kemi ne, si komision, për ligjin për ta futur në praktikën parlamentare, ose ta tërheqin propozuesit dhe ta kompletojnë sipas konsultimeve që do të bëjnë edhe me grupet e interesit.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Fadil, po e sqaroj edhe një herë. Është futur. Kam biseduar edhe me stafin e shërbimit të seancave. E kanë futur në kalendar thjesht për të respektuar afatin 8-javor, që në momentin kur është propozuar nga LSI-ja. U vendos në dhjetor se nuk kishte arsye për të kaluar me procedurë të përshpejtuar. Ndaj, tani që iku dhjetori, kur sapo kishin filluar protestat, iku emergjenca. LSI-ja po kërkon shtyrjen, sepse ata janë propozuesit. Nëse për ju janë dy gjëra të ndryshme protesta e studentëve që ka 9 kërkesa dhe këto 2 amendamente që janë 2 nga kërkesat e studentëve, unë nuk shoh dallim midis tyre. Pra, doni apo s' doni ju, për sa kohë do të diskutohet ligji për arsimin e lartë, këtu do të diskutohen të gjitha çështjet, problematikat dhe shqetësimet që janë ngritur nga implementimi i ligjit për arsimin e lartë.

Kemi anëtare këtu edhe ish-ministren, e cila mund të na japë informacion të bollshëm; do të thërrasim edhe ministren për ta pyetur në lidhje me plotësimin e kërkesave dhe të amendimeve, për mendimin e ekzekutivit, për VKM-të e fundit që kanë dalë etj.. Nuk ka dallim njëra çështje nga tjetra. I kam çuar mbrëmë kryesisë së komisionit një propozim bazuar edhe në shtyrjen që ka kërkuar LSI-ja. Nëse propozuesit kërkojnë shtyrje, ju çfarë do të diskutoni? Unë nuk e kuptoj këtë. Është absurditeti më i madh, sepse s'ka ndodhur ndonjëherë kjo gjë.

E dyta, kemi mjaftueshëm precedentë në komision, pra janë shtyrë një sërë projektligjesh, për shkak se nuk kemi pasur kohë të mjaftueshme.

E treta, boll me talljen e studentëve! Përballuni me ata! Do t'i thërrasim këtu.

Edhe asambleja e pedagogëve, që është mbledhur para disa ditëve, ku ishin qindra pedagogë, ka dalë me një sërë kërkesash, të cilat duhet t'i trajtojmë. Na kanë kërkuar edhe

përfaqësi për t'i dëgjuar në komision. Ka lënë afat të premtën, kur duhet t'i dëgjojmë patjetër. Çfarë nxitimi keni ju në këtë rast, nëse LSI-ja nuk e ka me nxitim? Cila është logjika që ju doni ta fusni dhe nesër në 19:00, kur nuk ka as media, as interes, të bëni dëgjesa? Deri këtu nuk kishit arritur ndonjëherë! Kaq ushtarë sa po tregoheni tani, nuk jeni treguar ndonjëherë! Hajdeni e bëni detyrën tuaj. Do të japim një javë kohë, ashtu sikurse është kërkuar, dhe do të ndjekim një kalendar. Në qoftë se keni komente e sugjerime, hajdeni t'i shtojmë.

Më lejoni të hedh në votë propozimin që u bë nga unë dhe nga zoti Boçi për të thirrur nesër në mëngjes në një seancë dëgjimore urgjente ministrin e Brendshëm për dhunën që është ushtruar brenda ambienteve universitare. Është një seancë dëgjimore urgjente, sepse nuk duhet dhe është shkelje e Kushtetutës dhe e ligjit për arsimin e lartë ndërhyrja me dhunë e Policisë së Shtetit, e urdhëruar me siguri nga lart, brenda ambienteve universitare.

E hedh në votë.

Çfarë do të diskutosh?

Milva Ekonomi – Unë kam propozuar para jush një kalendar për ditën e nesërme.

Albana Vokshi – Ku është?

Milva Ekonomi – E thashë sapo filloi seanca.

Albana Vokshi – Ku e ke të shkruar?

Milva Ekonomi – Ta thashë me gojë. E ke në procesverbal. Sapo filloi seanca të thashë që grupi ynë propozon që nesër të bëjmë dëgjesa.

Albana Vokshi – A mund t'i hedh propozimet në votë?

Na lini t'i hedhim në votë.

Milva Ekonomi – Po, pra, shumë mirë, ramë dakord. T'i hedhim propozimet në votë. Ndërkohë, unë propozova që...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

A mund ta mbaroj dhe mund ta përsëris propozimin që bëra? Unë propozova që nesër paradite të bëjmë një dëgjesë me ministren dhe ta ndajmë kohën. Ne jemi mësuar të bëjmë tri-katër dëgjesa në këtë komision, i kemi bërë bashkë, ashtu sikurse jemi mësuar të bëjmë dëgjesa edhe në orën 18:30, pra kemi eksperiencë për këtë gjë. Nuk është hera e parë. Unë propozova që nesër të bëjmë një dëgjesë me ministren dhe me grupet e interesit, me studentët dhe pedagogët.

Ndërkohë, më pas erdhi diskutimi për të bërë një dëgjese me ministrin e Brendshëm. Jemi shumë dakord, por të respektojmë radhën e propozimeve që erdhën këtu.

Albana Vokshi – Ju lutem, boll me hile! Të jemi të ndershëm! Jua kam çuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Që ta bëjmë pak më konkrete, ty edhe Fidelit jua kam çuar dje pasdite. U kam thënë nëse keni komente, sugjerime, para se të shkojmë në mbledhjen e komisionit për të mos bërë këtë rrëmuje, se ishte e panevojshme, pra në qoftë se do të kishit për të diskutuar më parë, ju lutem m'i thoni, por ju heshtët. Sapo ne bëmë propozimin, ju nxorët... Është i qartë skenari që ju po tentoni të aplikoni në këtë rast. Po ju them se keni një draft, bazuar edhe në kërkesën e LSI-së, për ta shtyrë, dhe, ju lutem, mos bëni gabime të tilla, sepse e kemi në procedurë që duhet diskutimi dhe prezantimi në parim njëherë. Si i kapërceni ju këto procedura? Është diskutimi në parim. Dy propozuesit, kur të kenë kohë, të vijnë dhe të na shpjegojnë pse na i kanë propozuar këto amendime. Si mundet që, pa bërë diskutimin në parim, të kalojmë te dëgjesa për të njëjtin projektligj? Më fal, por mos bëni kaq shkelje procedurash! Për të mos ju sjellë ju nga rrethet çdo ditë, mendova të bëjmë miratimin në parim, dëgjësën me Kejdin dhe me Flaidën, dhe menjëherë pas kësaj dëgjese të thërrasim ministrin. Diskutimet, përderisa janë shumë, t'i bëjmë një herë e mirë, që t'ju kursejmë edhe juve kohë, edhe atyre që na ndjekin, sepse do të jenë të njëjtat diskutime. Kjo është logjika e asaj që ne kemi ndjekur në propozimin që ju kam vënë mbi tavolinë dje. Meqenëse të martën e kishim të lirë dhe meqenëse edhe këto momente po ushtrohet dhunë nëpër universitete, ne gjujmë se është emergjente thirrja në seancë dëgjimore e ministrit Sandër Lleshaj. Nuk mund të presim ne që fëmijët tanë të vazhdojnë të dhunohen. Të vijë këtu. Nëse ju nuk pranoni, ne do ta bëjmë me firmë, me një të tretën. Kush është dakord që nesër të vijë ministri Lleshaj?

Milva Ekonomi – Të vijë ministrja e Arsimit, se është propozimi i parë...

Albana Vokshi – Pasnesër. Duhet bërë diskutimi në parim, Milva.

Milva Ekonomi – Unë propozova që ministrja e Arsimit të vijë nesër, pse nuk hidhet në votim propozimi i parë?

Albana Vokshi – Nuk është i pari ai. Më fal, e keni këtu propozimin e parë.

Milva Ekonomi – Ju lutem, ne kemi dy propozime: njëri që është draftkalendari, sepse është zakon që kryetarja bën një draftkalendar, që e ndan me nënkryetaren dhe me sekretarin,

është kërkesë e Rregullores. Ne punojmë herë me shkrim dhe herë biem dakord me gojë. Në këtë rast, Albana bëri një draft, ne e diskutuam dhe unë erdha me një propozim në fillim të mbledhjes, pra që nesër të thërrasim në dëgjese ministren e Arsimit. Këtë propozim ju e dëgjuat sot. Unë po ju them që, para se të kalojmë të ministri i Brendshëm, të hedhim në votë propozimin që bëra unë...

Luçiano Boçi – Për çfarë do ta thërrasësh, Milva, se nuk po të kuptoj? Do ta diskutojmë në parim propozimin, pastaj do të thërrasim edhe ministren.

(Diskutime pa mikrofon)

Albana Vokshi – Duhet diskutimi në parim. Duhet të dëgjojmë një herë. Meqenëse duhet...

Milva Ekonomi – Ne po ndjekim një gjë dhe këtu u kristalizua një ide që erdhi nga diskutimet tona. Kemi një amendim që ka bërë LSI-ja dhe vetë LSI-ja kërkon shtyrje, sepse kërkon të bëjë më shumë diskutime që lidhen me 8+ pikat. Ndërkohë, kemi një ligj, të cilin e kemi depozituar, dhe zoti Nasufi e tha këtë gjë, të cilin ose do ta tërheqim nga parlamenti, ose do të bëhemi gati për në datën 31. Ky është një vendim që nuk e marrim dot vetëm këtu, por do të pyesim shërbimet e parlamentit. Në këtë rast, a do të bëjmë dëgjese me ministren nesër?

Albana Voksh – Jo, nesër, pasnesër, se është më urgjente dhuna.

Milva Ekonomi – Pse është më urgjente?

Albana Vokshi – Sepse po ushtrohet dhunë tani që flasim...

Milva Ekonomi – Kush të tha ty?

Albana Vokshi – Merri edhe lexoji.

Milva Ekonomi – Nga t'i lexoj, nga informacionet që vijnë në celularin tënd?

Luciano Boçi – Kanë dalë me video.

Luan Baçi – Milva, bëjmë një sqarim të vogël. Kolegët e LSI-së nuk janë dakord të vazhdojnë me amendimet e tyre...

(Reagim pa mikrofon.)

E kanë tërhequr. E njëjta gjë është: kërkojnë shtyrje. Të mos bëjmë lojë fjalësh, ju lutem! Me gjithë respektin, po bëjmë lojë fjalësh. Ata pothuajse janë tërhequr dhe po thonë se do ta shtyjnë...

Albana Vokshi – Nuk është tërhequr, edhe një herë, kërkojnë të shtyhet në kohë, që të mos tallemi. Meqenëse nuk janë tërhequr, duke pasur precedentët... Ju lutem, erdhi Kejdi dhe tha se duan ta shtyjnë në kohë...

(Reagim pa mikrofon.)

Ju lutem, nuk janë tërhequr, por kërkojnë shtyrje në kohë.

Meqenëse nuk ka nxitim, kemi propozuar të mërkurën. Kemi dakordësuar edhe me dy propozueset që të vijnë ta bëjnë prezantimin e dy amendamenteve të tyre ditën e mërkurë në mëngjes dhe, menjëherë pas kësaj, të vijë ministrja e Arsimit. Meqenëse tani situata është emergjente, sepse tani që po flasim po ushtrohet dhunë brenda universiteteve, e kemi emergjente që nesër të paraqitet ministri i Brendshëm. Çfarë ka për të mos kuptuar në një gjë që është urgjente dhe në një tjetër që nuk është urgjente?

Atëherë, kush është dakord që nesër, në orën 10:00, të vijë para komisionit ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj, për të raportuar në lidhje me dhunën e ushtruar nga Policia e Shtetit brenda ambienteve universitare? Pra, kush është dakord me çfarëdo ore që të zgjedhë ministri nesër në mëngjes?

(Diskutime pa mikrofon.)

Ju lutem, kush është dakord, sepse në të kundërt do të marrim 1/3-at e firmave? Kush është kundër që ministri të vijë nesër për të raportuar lidhur me dhunën e studentëve, që edhe tani po ushtrohet? Nuk ka.

(Diskutime pa mikrofon.)

Nëse ju nuk keni informacion, unë nuk kam çfarë të bëj! Ju duhet të keni kontaktet tuaja që të informoheni. Më vjen keq, por i bie nuk po e bëni mirë detyrën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më vjen keq, por dhuna nuk sajohet, sepse atje ka shkuar ambulanca.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë, ne do t'i dërgojmë ministrit, në mënyrë zyrtare, kërkesën për t'u paraqitur nesër në orën 10:00. Nëse ai nuk ka mundësi të paraqitet në orën 10:00, atëherë le të paraqitet në orën 11:00. Pra, ne ia lemë ministrit të zgjedhë orarin për të ardhur dhe për të raportuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ata abstenuan, por nuk janë kundër!

(Diskutime pa mikrofon.)

Atëherë, meqenëse deputetët e LSI-së kanë kërkuar shtyrje, kush është dakord me propozimin e kalendarit? Ky kalendar është dërguar mbrëmë dhe akomodon edhe kërkesën e deputetëve të LSI-së për shtyrje, me një javë, të diskutimit në seancë plenare dhe për dëgjuesin, në mënyrë që t'i lihet kohë për diskutim secilës kërkesë që ka ardhur nga studentët, nga asambleja e pedagogëve, të cilët kanë vënë edhe një *data line* këtë të premte, nga senatet e universiteteve, si dhe ministres së Arsimit, në mënyrë që të gjithë të marrin kohën e mjaftueshme.

Kush është dakord me propozimin e bërë nga unë dhe nga deputetë e opozitës?

Milva Ekonomi – A mund të bëj një pyetje?

Albana Vokshi – Po.

Milva Ekonomi – A mund të informohemi më parë për shtyrjen dhe më pas ta miratojmë këtë gjë? Sa do të shtyhet?

Albana Vokshi – Një javë

Milva Ekonomi – Po, por kjo shtyrje nuk është pasqyruar në kalendarin e punimeve.

Albana Vokshi – Më falni, zonja Milva, por ne kemi bërë shumë herë shtyrje, ndaj të mos bëjmë lojëra fjalësh!

Milva Ekonomi – Unë nuk po bëj lojëra fjalësh.

(Diskutime pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Milva, para se të vija këtu, unë e diskutova këtë gjë edhe me zonjën Moza Pano, e cila më tha se nuk ka asnjë problem, pasi e kemi bërë edhe herë të tjera. Pra, nëse nuk ka kohë të mjaftueshme për të diskutuar dhe për të bërë dëgjues për projektligje të ndryshme, ne i kemi shtyrë jo me javë, por i kemi shtyrë edhe me muaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Atëherë, unë mendoj se ne të tre duhet të shkojmë të shikojmë këtë gjë në kalendar dhe të propozojmë për komisionin një kalendar sipas shtyrjes. Në qoftë se ka një shtyrje, ne duhet ta dimë a është për një javë apo për dy javë. Ne jemi në fillimin e punimeve dhe kemi një kalendar, të cilin ju e keni parë që kishte shumë ligje, ndaj, hajdeni, të shkojmë të pyesim.

Luan Baçi – A mund të jap një mendim? Unë do t’u thosha kolegëve të LSI-së që propozimi për amendimin e ligjit për mua nuk duhet të ekzistojë fare, për arsye se ne jemi për anulimin e ligjit komplet dhe vetë profesor Rrokaj e tha një gjë të tillë. Kështu që...

Albana Vokshi – Zoti Luan, unë jam në kontakt me Kejdin dhe kolegët e tjerë të LSI-së, por, për fat të keq, ata ndodhen te Komisioni i Ekonomisë dhe thanë se nuk do ta tërheqin këtë projektligj, por do ta shtyjnë në kohë. Kështu që, përderisa ata duan që ta shtyjnë në kohë, ne në kalendarin që kemi propozuar mund të rregullojmë edhe shtyrjen. A jeni dakord me këtë kalendar? Nëse jeni dakord me këtë kalendar, atëherë ne do të bëjmë shkresat dhe të mërkurën të vijmë dy propozuesit dhe ministrja. Unë nuk e di se çfarë nuk po kuptoni?!

Milva Ekonomi – Unë e propozova e para këtë gjë dhe po ju them se me dëgjesat edhe ne jemi shumë dakord. Meqenëse ju po kërkon shtyrje, unë po ju them që të pyesim për datën...

Albana Vokshi – Kam pyetur unë, Milva..

Milva Ekonomi – Më lini të mbaroj! Pra, këto dëgjesa që kemi parashikuar këtu, t’i vendosim sipas datave. Unë këtë kam thënë që në fillim, në qoftë se ligji futet në datën 31, atëherë duhet ta mbarojmë nesër, duhet të bëjmë dëgjesa, por në qoftë se ligji është shtyrë, atëherë hajdeni të akomodojmë dëgjesat.

Albana Vokshi – Atëherë, ligji është shtyrë, sepse propozuesit kanë kërkuar shtyrje dhe për këtë kanë folur edhe me Shërbimin e Seancave. Meqenëse ju nuk doni që ta bëjmë dy javë, atëherë a jeni dakord që ta bëjmë nesër dëgjesën, sepse e keni të detyrueshme në bazë të Kushtetutës dhe të Rregullores? A jeni dakord që të paktën dëgjesën e parë ta bëjmë pasnesër? A jeni dakord që të mërkurën të flasin dy propozuesit dhe të bëjmë diskutimin në parim dhe po të mërkurën të thërrasim ministren e Arsimit në dëgjesë? Kështu edhe ju, edhe ne, biem dakord për këtë. Pra, a biem dakord që të paktën të shkojmë deri të mërkurën dhe më pas të flasim për të tjerat?

Milva Ekonomi – Po, jemi dakord që të shkojmë deri tek e mërkura, por pasi ne të tre të marrim informacion te Shërbimi i Seancave të Kuvendit.

Albana Vokshi – Milva, ti po vë në dyshim atë që po them unë?!

Milva Ekonomi – Jo, nuk e vë në dyshim.

Albana Vokshi – E vendos komisioni nëse do të shtyhet apo jo, pra e vendosim ne.

(Diskutime pa mikrofon.)

Atëherë, po e hedh në votë javën e parë të kalendarit që unë kam propozuar?

A jeni dakord që nesër të bëjmë një dëgjese urgjente me ministrin Sandër Lleshaj lidhur me dhunën në ambientet e universitetit? Atëherë, lidhur me këtë propozim ne do ta kërkojmë me 1/3 –at.

A jeni dakord që ditën e mërkurë të bëjmë diskutimin në parim të projektligjit dhe, më pas, të bëjmë dëgjesën me ministren e Arsimit? Dakord!

Së fundi, kemi edhe një çështje tjetër, të cilën ne kemi muaj që e shtyjmë, lidhur me kandidaturat për Këshillin Drejtues të RTSH-së. Ne i kemi marrë informacionet dhe kandidaturat, ndaj, ju lutem, mund t'i shikoni kandidaturat.

Milva Ekonomi – Ne e kemi kandidaturën gati vetëm për një post.

Albana Vokshi – Atëherë, ju keni një kandidaturë, kurse ne kemi dy. Prandaj ne do të lëmë edhe një dëgjese me kandidatët që kanë aplikuar, të cilën do ta planifikojmë unë bashkë me zonjën Milva dhe me zotin Fidel.

Këtu mbledhja mbyllet!

MBYLLET MBLEDHJA